



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.83, datë 28.04.2022

PËR PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57 pika 2 dhe 4, të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. Përfundimin para afatit të kohëzgjatjes së komandimit, miratuar me Vendimin e KLP Nr. 8, datë 20.01.2020, të magjistratit **Arens Çela**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kthimin e Z. Arens Çela në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
3. Të njoftohen për këtë vendim Z. Arens Çela, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më datë 28.04.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
MIRELA BOGDANI